
BULETIN INFORMATIV

Shtator 2024

AKADEMIA E SHKENCAVE
E SHQIPËRISË



**Buletin mujor i aktiviteteve të Akademisë së
Shkencave të Shqipërisë**

Shtator, 2024

Përmbajtje

Projektet e Albanologjisë / Enciklopedia shqiptare	6
Mbledhje informuese e RV (redaksisë vendore) dhe anëtarëve të redaksisë qendrore të "Enciklopedisë shqiptare", me pjesëmarrjen e kryeredaktorit Skënder Gjinushi	7
Tri redaksi të "Enciklopedisë shqiptare" - shqyrtim e rishqyrtim kritik-përzgjedhës fjalësve të fushave të tyre	10
Redaksia për letërsinë - mbledhje për stabilizimin e fjalësit të bashkuar të fushës dhe diskutimin e mëtejshëm në takimin me redaksinë gjegjëse në Prishtinë	13
Redaksitë e "Enciklopedisë shqiptare" ngritur sipas fushave zhvillojnë takime në Prishtinë me redaksitë gjegjëse për të diskutuar e vendosur për fjalësin e përzgjedhur	17
Redaksia për luftën çlirimtare në Kosovë (1998-1999) dhe redaksia e historisë ushtarake (Tiranë) - drejt përzgjedhjes së thelluar të fjalësve të propozuar prej tyre për "Enciklopedinë shqiptare"	21
Redaksitë e ngritura në Shqipëri e në Kosovë për historinë e shekullit XX në kuadër të projektit madhor të "Enciklopedisë shqiptare" zhvilluan një takim pune në Prishtinë për të diskutuar mbi gjendjen dhe ecurinë për fjalësin e përbashkët	23
Takim në Prishtinë i dy redaksive të ngritura për mediat dhe komunikimin në kuadër të projektit për hartimin e "Enciklopedisë shqiptare"	26
Katër redaksi të "Enciklopedisë shqiptare" zhvillojnë takime pune në Prishtinë për njësimin e fjalësit të saj	28
Bordi i drejtorëve	30
Bordi i drejtorëve të njëjësive afatgjata dhe të përkohshme mbledhet për të marrë vendime për akte rregulluese dhe riorganizime	31
Promovime	34
Paraqitet në panairin e Tuzit botimi i Akademisë së Shkencave "Kadare në gjuhët e botës" (vëllimi I-II), përgatitur nga prof. Bashkim Kuçuku	35
"Kur sunduesit grinden", vepra e fundme e shkrimtarit akademik Ismail Kadare, së shpejti edhe në Podgoricë	37
Aktivitete	38
Mbledhja e Komisionit të ekonomisë, çështjeve sociale dhe juridike	39

5 shtatori, Dita e Nënë Terezës.....	44
Akad. Arben Merkoçi, drejtues i njësisë "NanoAlb" pranë Akademisë së Shkencave - referues në seancën plenare të kongresit të 6-të ndërkombëtar për biosensorët organizuar në Konya (Turqi), nga Universiteti i "Necmetin Erbakan".....	48
Akad. Nazim Gruda hapi sot seminarin shkencor “Burimet e reja natyrore të molekulave bioaktive për ushqimin e njerëzve dhe të kafshëve” në Universitetin Lituanëz të Shkencave Shëndetësore në Kaunas	50
Sesioni shkencor me temë “Antifashizmi shqiptar, si vlerë mbarëshqiptare”	52
Akad. Nazim Gruda merr pjesë në konferencën e 4-të ndërkombëtare mbi aktualitetet shkencore dhe inovacionet në hortikulturë (Kaunas, Lituani).....	54
Akad. Nazim Gruda, folës kryesor dhe bashkëdrejtues i simpoziumit për kultivimin në mjedise të mbrojtura, rrjetat dhe mbulesat e tjera, që po mbahet në Athinë.....	57
Çelet ekspozita “Trigonometria shpirtërore e Danjollit” në Akademinë e Shkencave.....	59
Takime pune	61
Takim pune me një përfaqësi të Akademisë së Shkencave të Rumanisë.....	62
Akad. Skënder Gjinushi, Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, priti sot në një vizitë zyrtare ambasadorën e Zvicrës znj. Ruth Huber	63
Vlerësime.....	66
Ceremoni e dorëzimit të diplomave dy anëtarëve të jashtëm të Akademisë - dr. Gëzim Alpion e dr. Lulzim Tafa	67
Anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, njëherazi presidenti i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, akademik Anastas Angjeli, vlerësohet me çmimin ndërkombëtar Books for Peace 2024” për kontributin e tij në dobi të paqes.....	71
Të tjera.....	73
Diskutohet projekti i rregullores së re për periodikët që botohen nga Akademia e Shkencave dhe rrjeti i instituteve të saj.....	74
Akademia e Shkencave është një tempull që i shërben kombit dhe Shqipërisë - kjo është arsyeja kryesore pse e pranova me shumë kënaqësi anëtarësimin si i jashtëm	76
Tre anëtarë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë përsëri në listën e shkencëtarëve më të shquar në Botë	78
Qendra Kërkimore e Bioteknologjisë dhe Gjenetikës e Akademisë së Shkencave boton artikullin e 5-të mbi ecurinë e përgjigjes imunitare të popullatës shqiptare ndaj COVID 19 ...	79

InterAcademy partnership (IAP) në buletin elektronik për muajin shtator publikon artikullin për Akademinë e Shkencave dhe qendrën kërkimore NanoAlb	81
Sot është dita kombëtare e trashëgimisë kulturore	82
Botime të reja	84
Botohen "në linjë" aktet e konferencës shkencore ndërkombëtare kushtuar Shtetit të Arbërit dhe shekujve të humanizmit europian në botën shqiptare.....	85
In memoriam.....	87
Sot ditëlindja e themeluesit të shkollës moderne të historiografisë shqiptare, bashkëthemeluesit dhe kryetarit historik të Akademisë së Shkencave, Aleks Buda	88

Projektet e Albanologjisë / Enciklopedia shqiptare

Mbledhje informuese e RV (redaksisë vendore) dhe anëtarëve të redaksisë qendrore të "Enciklopedisë shqiptare", me pjesëmarrjen e kryeredaktorit Skënder Gjinushi

- Në rend të ditës informimi për ecurinë e punës për fjalësin e "Enciklopedisë" dhe ndjekja e këtij procesi prej koordinatorëve, anëtarë të RV -



Pas fjalës së kryeredaktorit Gjinushi, i cili u përqendrua në kuptimin e zbatimit e rekomandimeve të RQ (redaksisë qendrore), relatuan për gjendjen e punës për fjalësin e përbashkët (të bashkuar) akad. Shaban Sinani (drejtues i redaksisë vendore) e dr. Arian Leka (QBEA), si dhe anëtarët e pranishëm: akad. Kosta Barjaba, akad. Anila Hoda, prof. Perikli Qiriaz, akad. Dhimitër Haxhimihali, akad. Adem Bunguri, prof. Aljula Jubani dhe akad. Marenglen Verli.

U raportua prej tyre për punën si koordinatorë të grupfushave të redaksive.

Nga pikëpamja teknike e formale vërehet se fjalësi, në pjesën sunduese, është numerizuar dhe alfabetizuar me rendin mbiemër-emër, gjë që lehtëson hapat e mëtejshëm të procesit drejt fondit themelor.

Nga 27 redaksi, 21 prej tyre kanë tashmë fjalës të përbashkët me redaksitë gjegjëse në Kosovë. Takime paraprake në grupfusha janë bërë 7 nga 11 të parashikuara; takimet e pjesës së dytë do të zhvillohen sipas kalendarit.

Fjalësi i propozuar për trashëgiminë shqiptare nga redaksia e posaçme në MV (i fundmi i dërguar më 22 gusht) është integruar në fjalësit e redaksive të fushave.

Puna me fjalësin e përbashkët e ka kaluar fazën e inventarizimit të artikujve enciklopedikë dhe është përqendruar në konkretizimin e kriterëve të unifikuara të përzgjedhjes (pragjeve) dhe riadresimin e propozimeve e mangësive të hasura, si dhe në rregullimin e raporteve midis termave të përgjithshëm (ngjarje, dukuri, zhvillime, pasuri të tokës e nëntokës, terma teknikë) e atyre të përveçëm (personalitete, vende, male, lumenj, subjekte, ente, institucione).



Krahas me njëjtësimin e pragjeve të pranimit të propozimeve, punë e rëndësishme është bashkimi i të ngjashmëve në artikuj të përbashkët, shmangia e mbivendosjeve, saktësimi i imët i përkatësisë së njësisë enciklopedike drejt redaksisë ku termi gjen shprehjen më të plotë.

Redaksitë që u janë bashkuar së fundmi atyre që punojnë me fjalës të përbashkët janë: trashëgimia kulturore dhe identiteti kombëtar, arkeologjia dhe lashtësia, historia ushtarake dhe ajo e Luftës së Dytë Botërore (nga ana ushtarake) dhe ekonomia e financat, ndërkohë që redaksia e letërsisë ka kryer bashkimin formal të fjalësit.

Takimet mes redaksive të grup-fushave të afërta, sipas ngjashmërive apo interesit të shprehur, filluan sipas një kalendari të miratuar në fund të muajit korrik dhe vijuan përgjatë muajit gusht. Takimet do të mbyllen më 13 shtator, për t'u vijuar më tej me redaksitë në Prishtinë.



Në fjalën e tij Kryetari akad. Skënder Gjinushi pati në fokus kryesor vazhdimësinë e punës për hartimin e listave të unifikuara e të stabilizuara të artikujve. Ai tha se ky është një vit që duhet të mbyllet me një listë të njësuara.

Kryetari foli dhe për rolin e anëtarëve të redaksisë vendore si koordinues për respektimin e kriterëve prej redaksive të fushave dhe për shmangien e vonësive. Ai theksoi se përgjegjësia për cilësinë e lëndës përfundimtare e të veprës në tërësi nuk është vetëm e autorit që shkruan artikullin, por edhe e redaksive vendore e të asaj qendrore. Kur materialet bashkohen e marrin formën përfundimtare përgjegjësia u shkon gjithë redaksive. Ndarja e redaksive në grupfusha është bërë për të ndihmuar që fushat të konsultohen me njëra-tjetrën e të zbatojnë njëloj kriteret e udhëzimet, dhe këtu koordinatorët kanë një rol të veçantë.

Tri redaksi të "Enciklopedisë shqiptare" - shqyrtim e rishqyrtim kritik-përzgjedhës fjalësve të fushave të tyre



- Sistemet politike e drejtësia, sportet dhe historia në takime pune të thirrura nga koordinatorët për të diskutuar për çdo titull njësie -

- Pjesëmarrës në të tre takimet drejtuesi i redaksisë për trashëgiminë shqiptare në MV prof. dr. Aziz Pollozhani -

- Nga redaksia për sistemet politike e drejtësinë relatoi akad. Aurela Anastasi, drejtuese e saj. Nga redaksia për sportet ishin të pranishëm dhe paraqitën rezultatet dhe problemet prof. Lluka Heqimi dhe prof. Leonidha Toska; nga redaksia për historinë - prof. asoc. dr. Edmond Malaj, akad. Beqir Meta dhe prof. asoc. dr. Marenglen Kasmi -

- Koordinatorët: akad. Kosta Barjaba, akad. Marenglen Verli e akad. Adem Bunguri; dr. Arian Leka (QBEA) e prof. dr. Shaban Sinani (drejtues i redaksisë vendore) gjithashtu të pranishëm -

- Për redaksinë e ngritur për sistemet politike e drejtësinë ky është këshillimi i dytë pas bashkimit të listave me redaksinë gjegjëse në Kosovë; për dy redaksitë e tjera - diskutim i parë -



U shtruan këto probleme:

1. Për të forcuar përzgjedhjen, njësitë që propozohen për nënkategori të trashëgimisë apo të mendimit e nocionet e përgjithshme të rekomandohet referimi brenda kategorisë;
2. Njësitë me shkallë përfaqësimi të kufizuar të bashkohen midis të ngjashmëve si dukuri e personalitete;
3. Zhvillimet historike paralele në hapësirën shqiptare të shihen të konverguara në një, përveç rasteve që ndikimi i historisë objektivist ka ndikuar për dallime; çfarë historia ka bashkuar të jenë bashkë dhe në "ESH";
4. Kur funksioni bashkon përmbajtjen e disa njësive, shkrirja në një është zgjidhje e këshilluar; në këtë rast brenda artikullit bëhet nëndarje me nëntituj dhe renditja e tyre bëhet alfabetikisht;
5. Në rastin e sinonimeve përmbajtësore (të plota a të pjesshme) për emërtime të përveçme të shprehura me variante formale të zbatohen të njëjtat zgjidhje si për gjithë leksikun e shqipes;
6. Emërtimet me karakter perifraxe, të zgjatura, të ngjashme me tituj referatesh dhe artikujsh në shtyp, të shprehen me strukturë të përmbledhur me ekonomi gjuhësore;
7. Për shkrirjen e njësive në artikuj përmbledhës apo për bashkime të tyre për shkak të njëjtësisë së kategorisë a të funksionit të veprohet njësoj si për ndarjen në

hapësirë, ashtu dhe për ndarjet në periudha kohore.



Të gjitha këto dhe çështje të tjera do të diskutohen edhe në takimet e përbashkëta me redaksitë gjegjëse në Kosovë gjatë gjysmës së dytë të shtatorit.

Në shtyp:

<https://sot.com.al/.../tre-redaksi-te-enciklopedise.../>

Redaksia për letërsinë - mbledhje për stabilizimin e fjalësit të bashkuar të fushës dhe diskutimin e mëtejshëm në takimin me redaksinë gjegjëse në Prishtinë



Për të njëjtën problematikë mbledhet redaksia për historinë ushtarake dhe LIIB, e drejtuar nga prof. asoc. dr. Marenglen Kasmi, me praninë e koordinatoreve, akad. Adem Bunguri e akad. Marenglen Verli) -

I.

- Sot në sallën "Akademikët", me pjesëmarrje në linjë të përfaqësuesve të redaksisë së posaçme për trashëgiminë shqiptare në Maqedoninë e Veriut (relator prof. dr. Fatmir Sulejmani) -

- Redaksia e fushës së letërsisë drejtohet nga prof. asoc. dr. Evalda Paci; pjesëmarrës në takim: akad. Stefan Çapaliku, prof. dr. Ymer Çiraku, prof. dr. Blerina Suta (në linjë) dhe prof. dr. Eldon Gjika -

- Koordinatorët për këtë fushë (akad. Shaban Sinani, drejtues i redaksisë vendore të projektit madhor të "Enciklopedisë shqiptare" dhe dr. Arian Leka, përgjegjës për botimet enciklopedike, QBEA), organizues e përkujdesës të takimit -



Në fillim të takimit, në emër të redaksisë së posaçme të ngritur në MV, prof. dr. Fatmir Sulejmani, studiues i letërsisë, shtjelloi renditjen dhe përzgjedhjen e zërave të veçantë dhe atyre përmbledhës, duke dhënë sqarime të nevojshme për zbatimin e njësojtë të kriterëve të pranimit dhe promovimit për çdo njësi të përfshirë në fjalësin përkatës të kësaj redaksie.

Gjatë kësaj mbledhjeje u risaktësuan emërtesa që kanë të bëjnë me terma të përgjithshëm dhe me artikuj përmbledhës në fjalësin ekzistues, si dhe u diskutua për kriterë të përfshirjes së njësive që kanë të bëjnë me personalitete të rëndësishme në fushë të studimeve letrare, historisë së letërsisë shqipe, kritikës letrare, studimeve krahasimtare, studimeve me vështrim diakronik dhe socioletrar.

Në ndonjë rast të veçantë dhe u rinënvizua domosdoshmëria e mënjanimin definitiv të pranisë së të njëjtit artikull në fjalësa të redaksive që kanë objekt të përafërt studimi, duke e shpënë më tej procesin e përmbylljes së këtyre të fundit.

Në këtë mbledhjeje u synua të përbashkoheshin zëra që në thelb janë të ngjashëm mes tyre, si dhe të saktësohen të dhëna mbi shtrirjen kronologjike të dukurive të caktuara letrare.

Për personalitetet joshqiptarë që e kanë prekur kalimthi ose në një moment botën shqiptare u rekomandua adresimi në artikuj tematikë ose përmbledhës, si dhe në brendësi të artikujve të figurave shqiptare me të cilat kanë pasur lidhje.

U vërejt se njësimi i niveleve të përzgjedhjes dhe vënies në hierarki në këshillimin e afërt me redaksinë respektive në Kosovë është një detyrë e afërt; kështu kalohet nga fjalësi i bashkuar në fjalës të njësuar.



U ritheksua se për personalitetet kriter themelor është vlerësimi si fenomene të realizuara, të kryera.

II.

Në sallën "Akademikët" u zhvillua takimi i radhës me redaksinë e historisë Uushtarake. Mbledhja u drejtua nga shefi i sektorit të nciklopedisë dr. Arian Leka, me pjesëmarrjen e gjithë anëtarëve të kësaj redaksie, e cila drejtohet nga prof. asoc. dr. Marenglen Kasmi. Në takim ishin ftuar të merrnin pjesë edhe përfaqësuesi i redaksisë qendrore akad. Marenglen Verli dhe anëtari përgjegjës për këtë fushë në redaksinë vendore akad. Adem Bunguri.

Në lidhje online morën pjesë në takim edhe prof. asoc. dr. Shkodran Imeraj (përfaqësues i redaksisë së fushës për luftën e Kosovës 1999 në Prishtinë si edhe prof. dr. Azis Pollozhani, drejtues i redaksisë së posaçme në Maqedoninë e Veriut.

Tema e diskutimit ishte harmonizimi i fjalësit enciklopedik ndërmjet tri redaksive dhe dalja në një fjalës të përbashkët.

Pas prezantimit të punës së bërë për hartimin e fjalësit enciklopedik në fushat e historisë ushtarake, rendit e sigurisë kombëtare, ku u shpjegua metodologjia e ndjekur për hartimin e tij duke respektuar rregulloret dhe udhëzimet përkatëse të nxjerra nga redaksia qendrore, u diskutuan me të pranishmit edhe problemet e hasura gjatë punës, si shmangia e përsëritjeve të titujve enciklopedikë, harmonizimi metodologjik i përzgjedhjes së artikujve me qëllim uljen e numrit të tyre pa prekur përmbajtjen.

Në fund të takimit të takimit të tri redaksitë u dakordësuan që në takimin e redaksivë që do të zhvillohet në Prishtinë më 19 shtator, të konkludohet për nxjerrjen e

listës së përbashkët përfundimtare të artikujve enciklopedikë për këtë redaksi.



Redaksitë e "Enciklopedisë shqiptare" ngritur sipas fushave zhvillojnë takime në Prishtinë me redaksitë gjegjëse për të diskutuar e vendosur për fjalësin e përzgjedhur



Takimet do të vazhdojnë gjatë gjithë periudhës 16-26 shtator: të gjitha redaksitë (27 në Shqipëri dhe 29 në Kosovë) deri atëherë duhet të kenë përfunduar njësimin e fjalësit.

Redaksia e gjuhësisë (Tiranë) dhe redaksia e albanologjisë (Prishtinë), të drejtuar nga prof. dr. Anila Omari e akad. Bardh Rugova, me pjesëmarrjen e anëtarëve të tyre (Shkumbin Munishi, prof. asoc. dr. Shpëtim Elezi, prof. asoc. dr. Vjosa Osmani dhe prof. dr. Mimoza Priku), u takuan të hënën, më 16 shtator. Puna e grupit u përqendrua në probleme të njësive të diskutueshme, në shmangien e moskoherencave. Në takim u diskutua dhe u morën vendime për fjalësin e përbashkët të këtyre dy fushave, në procesin e kalimit nga fjalës i bashkuar në fjalës të stabilizuar, të unifikuar.

Dy redaksitë gjegjëse për letërsinë (prof. asoc. dr. Evalda Paci, akad. Sabri Hamiti, prof. Nysret Krasniqi), të mbledhura në të njëjtën ditë, bënë saktësime e plotësime në punën drejt fjalësit të përbashkët të fushës. U konkludua se për të përmbyllur këtë fazë duhet dhe një takim tjetër së afërmi, në linjë ose direkt, pas të cilit regjistri do të jetë përfundimtar.



Redaksitë për arkeologjinë dhe lashtësinë (prof. Neritan Ceka, akad. asoc. Gëzim Hoxha, dr. Arianit Buçinca) kanë tashmë një fjalës të përbashkët, por përzgjedhja dhe stabilizimi do të vazhdojnë edhe më tej, deri në prag të mbledhjes së dy redaksive vendore. U diskutua edhe për çështje formale të paraqitjes së njësuar gjuhësisht të njëjësive enciklopedike me strukturë togfjalëshi apo perifraxe, për çka redaksia qendrore dhe dy redaksitë vendore kanë rekomanduar zgjidhjet e duhura.



Në takimin e dy redaksive të historisë (Mesjeta, Bizanti, periudha osmane) u këmbye informacion për përgatitjen e fjalësve të fushës. Redaksia e Tiranës (akad. P. Xhufi, prof. Ferit Duka, prof. Edmond Malaj), e cila e ka filluar me vonesë relative

punën, ka tashmë një listë emrash e emërtimeve prej mbi një mijë njësish, përgatitur nga anëtari i redaksisë Edmond Malaj. Redaksia gjegjëse e Prishtinës (prof. M. Malaj dhe akad. J. Bajraktari, me anëtarët e pranishëm prof. Bedri Muhadri, prof. Luan Tetaj) ka tashmë fjalësin e vet, të gatshëm për ta këmbyer me kolegët e më tej për të kaluar nga fjalësi i bashkuar në fjalës të përbashkët.



Përfaqësuesi i redaksisë vendore të Prishtinës akad. J. Bajraktari propozoi që fjalësi i përbashkët i kësaj fushe të realizohej deri më 8 tetor, ndërsa drejtuesi i redaksisë së Tiranës akad. Pëllumb Xhufi kërkoi pak më shumë kohë. Sidoqoftë, deri në fund të vitit edhe kjo redaksi do të jetë sinkronizuar me të tjerat. Në takim morën pjesë e diskutuan dr. Arian Leka (QBEA) dhe akad. Shaban Sinani (nga redaksia vendore e Tiranës).

Redaksitë gjegjëse të drejtësisë dhe sistemeve politike (të pranishëm prof. dr. Altin Shegani e akad. Arsim Bajrami); si dhe redaksitë për arsim e arsimim (drejtues dr. Geron Kamberi), me pjesëmarrje të plotë të anëtarëve, konfirmuan gjithashtu fjalësin e njësuar. Nga redaksia vendore e Prishtinës mori pjesë akad. Anton K. Berishaj.

Sot u realizua dhe takimi i redaksive të historisë për periudhën e Rilindjes (akad. J. Bajraktari, prof. Ferit Duka dhe akad. Frashër Demaj, drejtues të tyre) dhe me pjesëmarrjen e anëtarëve të dy redaksive prof. Albina Drançolli dhe prof. Gazmend Rizaj. Fjalësi i përbashkët paraqitet përfundimisht deri në mbarim të shtatorit.



Në shtyp e media:

<https://www.google.com/.../enciklopedia-shqiptare-mbledh.../>

<https://sot.com.al/.../projekti-enciklopedia-shqiptare.../>

<https://www.kultplus.com/.../enciklopedia-shqiptare.../>

<https://ashak.org/takime-te-redaksive-te-fushave-kosove.../>

<https://frekuenca.net/.../39857-enciklopedia-shqiptare...>

<https://ata.gov.al/.../enciklopedia-shqiptare-mbledh.../>

Redaksia për luftën çlirimtare në Kosovë (1998-1999) dhe redaksia e historisë ushtarake (Tiranë) - drejt përzgjedhjes së thelluar të fjalësve të propozuar prej tyre për "Enciklopedinë shqiptare"



- Deri në fund të muajit shtator 2024 do të arrihet një fjalës i bashkuar i dy periudhave specifike që mbulojnë këto dy redaksi, me veçanësitë e tyre, që lidhen me natyrën "ad hoc" të fushave / objektit që mbulojnë -

Gjatë takimit u theksua rëndësia e luftës çlirimtare në Kosovë jo vetëm për pavarësimin e saj, por edhe për ndryshimin e statusit gjeopolitik e kombëtar të mbarë shqiptarëve, që "hynë në shekullin e tyre".

Redaksia për luftën çlirimtare në Kosovë ka propozuar 581 njësi enciklopedike (numri i identifikimeve fillestare më shumë se dyfishi i kësaj shifre), një pjesë e mirë e të cilave (rreth një e treta) do të rigrupohen në njësitë/kategoritë tematike, institucionet, formacionet ushtarake dhe organizimet politike.

Synimi është që çdo trashëgimi e kësaj periudhe të ketë vendin e vet në "ESH", por duke respektuar disa përpjesëtime objektive midis fushave e disiplinave, përmes artikujve përmbledhës (çfarë ka bërë bashkë historia, rrjedha politike apo kulturore etj. duhet të jetë një artikull të përbashkët edhe në "Enciklopedi".

Reduktimi në numër njësisish nuk është kufizim për përfaqësimin e vlerave, por zgjidhje metodologjiksht e arsyetuar në respekt të parimeve të enciklopedizmit.

Redaksia për historinë ushtarake, pas diskutimit kritik, ka propozuar 391 njësi (përzgjedhur gjithashtu nga dyfishi i tyre). Ky proces do të vazhdojë edhe më tej,

përmes krahasimeve me redaksitë e periudhave të tjera historike, me redaksinë e arsimimit dhe redaksi të tjera.



Mbledhja u kryesua nga akad. Jusuf Bajraktari dhe dy drejtuesit e redaksive gjegjëse, historianët Marenglen Kasmi e Arbër Hadri (të cilët raportuan fillimisht në emër të tyre).

Të pranishëm me diskutime anëtarët e dy redaksive studiuesit Ibrahim Gashi, Sabit Syla e Shkodran Imeraj (redaksia e Prishtinës) dhe Xhavit Shala e Sami Neziri (redaksia e Tiranës).

Morën pjesë në këtë takim edhe Shaban Sinani nga redaksia vendore e Tiranës dhe Arian Leka (QBEA).

Diskutimet u zhvilluan me mirëkuptim e përgjegjësi shkencore.

Redaksitë e ngritura në Shqipëri e në Kosovë për historinë e shekullit XX në kuadër të projektit madhor të "Enciklopedisë shqiptare" zhvilluan një takim pune në Prishtinë për të diskutuar mbi gjendjen dhe ecurinë për fjalësin e përbashkët



- Sipas kalendarit të miratuar nga redaksia qendrore dhe dy redaksitë vendore -
- Një fjalës i bashkuar me më shumë përzgjedhje do të jetë gati deri në fillim të muajit dhjetor -

E drejtuar nga akad. Jusuf Bajraktari seanca e parë takimit të këtyre dy redaksive, që drejtohen gjegjësisht nga akad. Beqir Meta e prof. Fehmi Rexhepi, me pjesëmarrjen e anëtarëve të tyre: Ibrahim Gashi, Memli Krasniqi, Fitim Rifati dhe Armend Ahmeti, i përqendruan diskutimet e tyre në problematikat e përafrimit të ritmeve që e çon procesin nga niveli i shkëmbimit të fjalësit në gjendjen e fjalësit të bashkuar.

Seanca e dytë iu kushtua diskutimit kritik-përzgjedhës e njësuës të fjalësve.

Duke njohur gjerësinë dhe rëndësinë e këtyre redaksive për historinë e re të shqiptarëve u vlerësua shkëmbimi i informacionit, saktësimi i metodologjisë dhe vërtetimi i zbatueshmërisë së kritereve të përbashkëta drejt kalimit në fazën e punës me një fjalës për të njëjtën enciklopedi.



Nga të pranishmit dhe posaçërisht akad. Meta u theksua se, në krahasim me fjalësin e mëhershëm, shmangja e mbivendosjeve dhe e emërtimeve të dyfishta për të njëjtën referencë (Lufta II Botërore në Shqipëri e në Kosovë) dhe riadresimi i njësive enciklopedike drejt redaksive temakikisht të afërta apo në zona kufitare në kronologji ka ulur ndjeshëm numrin e njësive nga versioni i parë në versionin e paraqitur në këtë takim pune.

Nga redaksia e Tiranës përzgjedhja ka qenë mesatarisht një njësi në mbi pesë të propozuara në krye të herës. Përzgjedhja është bërë me një përpjesëtim të ngjashëm edhe në Prishtinë.

Në raportimin e tij mbi gjendjen dhe ecurinë prof. Fehmi Rexhepi nënvizoi se puna e redaksisë së Kosovës në marrëdhënie me redaksitë e afërta ka përfunduar, duke riadresuar shumë artikuj drejt redaksive për sistemet politike, religjionet dhe arsimimin.

U sugjerua që për dukuritë e ngjashme (të njëkohshme, të një rrjedhe a dukurie) të ketë një njësi të përbashkët enciklopedike; si dhe që për personat historikë të ish-Jugosllavisë, që shfaqen në historinë e shqiptarëve gjatë shekullit XX, në ndarjen e ardhshme të punëve të jetë prioritare redaksia që funksionon në Prishtinë.

Drejtuesi i redaksisë së Tiranës akad. Beqir Meta njoftoi për punën e saj, duke vënë në dukje se fillimisht është punuar me kujdes që të koleksionohet gjithë sa është vlerësuar si e rëndësishme për të qenë pjesë e "ESH", për t'i bërë shqyrtimet përzgjedhëse në një fazë të dytë, por duke respektuar kritere detyruese të njëjta.

Për respektim të pragjeve të njëjtë të pranimit dhe integrim të punës së dy redaksive foli dhe akad. Marenglen Verli, i pranishëm në këtë takim, me cilësinë e anëtarit të redaksisë qendrore (Tiranë).



Prof. Ibrahim Gashi theksoi se puna e redaksisë së Kosovës nuk është mjaftuar me lëndën e nxjerrë nga FEK apo FESH, por janë shfrytëzuar edhe punime monografike, burime enciklopedike të huaja, që i referohen kronologjisë që mbulon kjo redaksi, metodë pune kjo që ka sjellë pasurim të prurjeve dhe zgjerim në qasje.

Në takim morën pjesë e diskutuan dr. Arian Leka (QBEA) dhe akad. Shaban Sinani (nga redaksia vendore e Tiranës). U theksua se ngulmimi për reduktim të listave nuk nënkupton bashkimin mekanik e të sforcuar në artikuj të përbashkët, por reflektim ndaj faktit se aty ku historia na ka bërë bashkë të shprehemi bashkarisht, duke adresuar drejt kategorive përmbledhëse gjithë ata terma e artikuj jo të mjaftueshëm për të qëndruar më vete.

Diskutuesit u dakodësuan që deri në fundin e shtatorit të arrihet në një fjalës të bashkuar, duke saktësuar e stabilizuar prurjet si në kufi të arsyeshëm, ashtu edhe në respektim të raporteve midis fushave, periudhave etj.

Takim në Prishtinë i dy redaksive të ngritura për mediat dhe komunikimin në kuadër të projektit për hartimin e "Enciklopedisë shqiptare"



Në datën 24 shtator 2024 u zhvillua në Prishtinë takimi i parashikuar i redaksive të fushës "komunikim dhe mjete të komunikimit" për hartimin e fjalësit të njësuar.

Në këtë takim mori pjesë edhe zëvendëskryeredaktori i "Enciklopedisë shqiptare" akad. Mehmet Kraja. Ai vlerësoi punën e bërë nga dy redaksitë dhe paraqiti disa sugjerime për të përmbyllur me sukses fazën e parë të hartimit të kësaj vepre të madhe. Akad. M. Kraja theksoi se "Enciklopedia" jonë do të jetë enciklopedi nacionale për vlerat më të mira që kanë dhe kanë krijuar shqiptarët në historinë e tyre.

Përgjegjësi i redaksisë së Kosovës Binak Kelmendi dhe përgjegjësi i redaksisë së Tiranës Naim Zoto, si dhe prof. dr. Valbona Toska (nga redaksia e posaçme për trashëgiminë shqiptare në Maqedoninë e Veriut) informuan për punën e redaksive dhe problematikat e evidentuara. Anëtarët e këtyre redaksive (Rrapo Zguri, Mehmet Gjata, Albana Beqiraj) dhanë mendime sidomos në lidhje me kriteret për përfshirje dhe proporcionet strukturore mes artikujve.

U konkludua që koha deri në fund të shtatorit duhet të shfrytëzohet që lista e përbashkët e artikujve të rishihet edhe një herë për të reflektuar vërejtjet e apo sugjerimet gjatë kësaj konsulte ballafaqese.

Ky projekt i përbashkët i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës mbështetet dhe bashkëfinancohet nga qeveria e

Shqipërisë dhe e Kosovës.

www.akad.gov.al

Shih dhe:

<https://ata.gov.al/.../redaksite-e-enciklopedise.../>

Katër redaksi të “Enciklopedisë shqiptare” zhvillojnë takime pune në Prishtinë për njësimin e fjalësit të saj



Më 25 shtator 2024 u zhvilluan në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve në Prishtinë takimet e katër redaksive të “Enciklopedisë shqiptare” për njësimin e fjalësit të saj.

Redaksia e bujqësisë, redaksia e shkencave të natyrës, redaksia e inxhinierisë dhe teknologjive dhe redaksia e shkencave të mjedisit diskutuan dhe morën vendime të përbashkëta me redaksitë gjegjëse për përzgjedhjen e njësive enciklopedike që do të promovohen në këtë vepër madhore kombëtare.

Takimet e zhvilluara në dy seanca u drejtuan nga akademikët Fetah Podvorica dhe Fejzullah Krasniqi. Si koordinatore të caktuar nga redaksia vendore në Tiranë, në këto takime, përveç anëtarëve dhe drejtuesve të redaksive, morën pjesë edhe akademikët Anila Hoda dhe Ilirjan Malollari.

Redaksitë e shkencave të natyrës u përfaqësuan nga akademikët Floran Vila, Mimoza Hafizi, Ilia Mikerezi e Besnik Baraj dhe prof. Fatmir Hoxha (nga ASHSH), si dhe studiuesit Qamil Haxhibeqiri, Bexhet Mustafa e Sefer Avdia (ASHAK).

Redaksitë për shkencat e mjedisit u përfaqësuan nga profesorët Seit Shallari, Mihallaq Spiro (Tiranë), Salih Gashi, Andullah Alija, Sami Makolli (Prishtinë).

Në takimin e redaksive për industrinë dhe teknologjitë që drejtohen gjegjësisht nga akademikët Jorgaq Kaçani e Myzafere Limani ishin të pranishëm studiuesit Flamur Bidaj, Neritan Shkodrani, Alush Musaj e Mihone Kerolli.



Në takimin e redaksive për bujqësinë e blegtorinë (ekonomia e fshatit), në përbërje të të cilave janë akademikët Anila Hoda e Nazim Gruda e studiuesit Vjollca Ibro e Hajri Haska (Tiranë), ishin të pranishëm studiuesit Bajram Berisha, Kurtesh Sherifi, Sali Aliu dhe Skënder Kaçiu (Prishtinë).

Në takimin e përbashkët morën pjesë dhe akad. Shaban Sinani (nga redaksia vendore e Shqipërisë) dhe dr. Arian Leka (QBEA).



Për me tepër shih linkun:

<https://www.facebook.com/share/p/vZeX4Fq6pwC5YdG4/>

Takimet vazhdojnë deri në fund të kësaj jave

Bordi i drejtorëve

Bordi i drejtorëve të njësive afatgjata dhe të përkohshme mbledhet për të marrë vendime për akte rregulluese dhe riorganizime



- Me pjesëmarrjen e drejtorëve të instituteve, qendrave e njësive të kërkimit dhe të kryetarëve të këshillave e bordeve shkencore të tyre -
- Nën drejtimin e akad. Skënder Gjinushit, kryetar i Akademisë së Shkencave -



Bordi i drejtorëve, pas diskutimit në tërësi dhe për çdo nyje, miratoi rregulloren e re për periodikët që boton Akademia e Shkencave dhe rrjeti i institucioneve pranë saj, si dhe për politikën editoriale të tyre.

Rregullorja u miratua më parë nga kryeredaktorët aktualë të periodikëve dhe koordinatorët e redaksive të tyre. Me miratimin e saj revistat shkencore do të kenë status konkurrues ndërmjet periodikëve shkencorë brenda dhe jashtë vendit.

Në përfundim projekti u miratua dhe u la një afat i shkurtër pritjeje për riformulime të mundshme në nene të veçantë.

Në vijim u raportua për veprimtarinë e grupeve të punës të ngritura me vendimin nr. 63 datë 26.6.2024 të Kryesisë për strategjinë e zhvillimit të kërkimit shkencor e ristrukturimin e instituteve të albanologjisë, si dhe plotësimet e amendimet e mundshme në Statut (kreu i shtuar për rrjetin e instituteve të albanologjisë). Në muajt e ardhshëm këto plotësime e amendime duhet të paraqiten për miratim përfundimtar në Asamble.



U bënë të njohura ndryshimet e propozuara për projekt-rregulloren e punësimit të personelit akademik sipas konceptit të paraqitur në mbledhjen e bordit të drejtorëve më 11 qershor 2024. Javën e ardhshme përfundon afati për pranimin e sugjerimeve. Ndërkohë, me rregullat e përkohshme që janë miratuar, ka nisur shpallja e konkurseve për vendet vakante në institute dhe faza e parë do të përfundojë brenda këtij muaji.

Bordi u informua për miratimin me vendim të Qeverisë të propozimit të Asamblesë për ngritjen dhe konstituimin e Qendrës Kërkimore të Bioteknologjisë dhe Gjenetikës, në zbatim të VKM nr. 298 datë 15.5.2024. Qendra ka filluar veprimtarinë e saj sipas këtij vendimi dhe perspektiva është që edhe njësi të tjera të përkohshme të kalojnë në këtë status me akte nënligjore.

U kërkua pëlqimi i bordit për krijimin e laboratorit të restaurimit pranë ASHSH, në funksion të fondeve të arkeologjisë dhe antropologjisë.



Një informacion i detajuar iu paraqit bordit nga akad. Gjinushi për projektligjin

“Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, hartuar nga ministria përgjegjëse për arsimin e shkencën dhe nga ASHSH, që pritet të miratohet nga Këshilli i Ministrave dhe më pas nga Kuvendi i Shqipërisë. Projektligji rregullon në tërësi sistemin e kërkimit shkencor në vend dhe pozicionin qendror të Akademisë në kuadër të tij.



Promovime

Paraqitet në panairin e Tuzit botimi i Akademisë së Shkencave "Kadare në gjuhët e botës" (vëllimi I-II), përgatitur nga prof. Bashkim Kuçuku



- Akademia e Shkencave për herë të tretë pjesëmarrëse në këtë panair: dhurohen botime të saj për bibliotekën e komunës

- Nderim me mirënjohjen e qytetit për ASHSH si institucion që mbështet zhvillimin e letërsisë, të botimeve dhe të librit shqip për shqiptarët e Malit të Zi dhe përgjithësisht për shqiptarët jashtë

- Botohen aktet e konferencës për xhubletën në UNESCO: "Xhubleta, dëshmitare e lashtësisë sonë", realizuar në vitin 2023, me pjesëmarrjen dhe mbështetjen e ASHSH

- Akademia e Shkencave dhe Arteve të Malit të Zi boton librin "Kada se vladari svadjaju" / "Kur sunduesit grinden" të Ismail Kadaresë, anëtar i jashtëm i saj. Këtë vit del nga shtypi vëllimi III i librit "Kadare në kritikën botërore" (Akademia e Shkencave e Shqipërisë)

- Të pranishëm shkrimtarë, studiues, botues, përkthyes, lexues, pjesëmarrës në panair

- Botimi paraqitet nga prof. Shaban Sinani



- Mediat publike të Malit të Zi njoftojnë për ngjarjen dhe për mbështetjen e vijueshme të Akademisë së Shkencave për panairin e Tuzit

"Kur sunduesit grinden", vepra e fundme e shkrimtarit akademik Ismail Kadare, së shpejti edhe në Podgoricë



- Kujdes i posaçëm për përkthimin e kësaj vepre u bë nga kryetari i mëparshëm i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Malit të Zi (CANU) akad. Dragan K. Vukčević dhe kryetari aktual i saj akad. Ljubiša Stanković -

"Kada se vladari svadjaju" ("Kur sunduesit grinden") përkthehet e botohet sipas marrëveshjes ndërakademike: ASHSH do të mbështesë botimin e një autori malazez në gjuhën shqipe.

Parathënia e këtij botimi është shkruar nga studiuesi Shaban Sinani.

Ismail Kadare ishte anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Malit të Zi dhe anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Bashkëpunimi midis ASHSH dhe CANU prej vitesh është ndërsjelltas i frytshëm. Bashkëpunimi përfshin me përparësi shkencat e identitetit: historinë, gjuhësinë dhe letërsinë, kulturën e trashëgiminë, artet pamore dhe muzikën.

Aktivitete

Mbledhja e Komisionit të ekonomisë, çështjeve sociale dhe juridike

Sot më 2 shtator 2024, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u zhvillua mbledhja e Komisionit të ekonomisë, çështjeve sociale dhe juridike.



Në këtë aktivitet akad. Anastas Angjeli dhe akad. Adrian Civici prezantuan dy ligjëratat akademike, përkatësisht:

- "Ekonomia sociale dhe roli i saj paqësor në zhvillimin e tregut"

- "Zhvillimet e kulturës digjitale: cilat janë sfidat me të cilat do të përballemi"

Mbledhjen e çeli akad. Anastas Angjeli. Në fjalën e tij, ai vuri në dukje se politikat dhe prioritetet themelore për modelin e ardhshëm të zhvillimit ekonomik dhe social, si në vendet e zhvilluara ashtu edhe në ato në zhvillim, janë një debat mbi 30-vjeçar që konsiston në ndërtimin e indekseve të reja për të matur elementët e rinj të vlerësimit të lumturisë dhe kënaqësisë së popullsisë në vendet kyçe, që përcaktojnë zhvillimin e përgjithshëm ekonomik global dhe zhvillimin industrial në veçanti.

Në ligjëratën e tij me temë "Ekonomia sociale dhe roli i saj paqësor në zhvillimin e tregut", akad. Angjeli tha se më 22 korrik u bënë 80 vjet nga marrëveshja e Bretton Woods-it, e cila krijoi edhe institucionet e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Bankës Botërore (BB) me elementin e parë të saj, Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim. E më pas, këtyre dy institucioneve të mëdha iu shtua edhe krijimi i Organizatës Botërore të Tregtisë, që në fillim u quajt GATT dhe sot është shndërruar në

OBT. Të trija këto organizma kushtëzuan krijimin e Sistemit Ndërkombëtar Monetar (Financiar) dhe krijuan kushtet për një botë më të integruar dhe më të ndërkombëtarizuar pas Luftës së Dytë Botërore. Më 15 tetor të këtij viti, Shqipëria bën plot 33 vite si anëtare e institucioneve të Bretton Woods-it, FMN dhe Bankës Botërore. Kjo do të thoshte që Shqipëria kishte tashmë mundësi të përpunonte strategjitë e saj të kalimit të krizës dhe të zhvillimit, programet e ndihmave, programet e investimeve, programet e tërheqjes së investimeve të huaja dhe të teknologjisë së përparuar, zhvillimin e reformave strukturore dhe të privatizimit, ato të tregut etj..



Akad. Angjeli vuri në dukje se shtetet, qeveritë, organizatat ndërkombëtare, si dhe ekspertët, janë mësuar të matin zhvillimin ekonomik duke përdorur tregues të tillë si GDP, inflacioni, deficit, shkalla e papunësisë, dominimi i tregut, etj. Masa shtesë kanë filluar të merren në konsideratë si përpjekje për të vlerësuar mirëqenien, nivelin e kënaqësisë që ofron jeta në qytet dhe tregues të tjerë indirekt të lumturisë.

Më tej akad. Angjeli foli për çështje të ekonomisë së mirëqenies. Ai theksoi se studiuesit ndahen në dy grupe. Grupi i parë argumenton se mirëqenia e përgjithshme kalon domosdoshmërisht nga individualizmi i njeriut dhe liria e tij në treg dhe grupi i dytë që mundohet të argumentojë se thellimi i pabarazive është prishja e bazës sociale të ekzistencës shoqërore dhe faktori kryesor i ndryshimit të sistemeve.

GDP dhe shkalla e kënaqësisë së individit janë në kontradiktë reale. Shkalla e pabarazisë në 30 vjetet e fundit u bë problem dhe në transformimet që pësuan vendet e Europës Lindore pas rënies e murit të Berlinit. U bë shqetësim pabarazia e krijuar me ritme shumë të shpejta.



Shqipëria nuk shpëtoi nga këto sëmundje dhe niveli i pabarazisë vazhdon ta shqetësojë atë edhe pse ekonomia shqiptare e ka përfunduar periudhën e gjatë, të vështirë e të mundimshme të tranzicionit.

Në fund të ligjëratës akad. Angjeli vuri në dukje se të gjithë studiuesit janë dakord për një gjë: PBB nuk është një tregues i mjaftueshëm për të përcaktuar zhvillimin ekonomik dhe janë të bindur se nevojiten tregues alternativ. Kjo sepse rritja ekonomike si tregues më vete nuk mund të kapë të gjitha dimensionet e progresit, kështu që ne nuk mund ta shohim PBB të vetmin tregues zhvillimit.

Akad. Angeli foli rreth kërkimit për tregues të tjerë alternative dhe për bizneset sociale në Shqipëri, ku vuri në dukje se nuk ekziston një klasifikim apo ndarje e qartë e ndërmarrjeve sociale, çka e bën thuajse të pamundur të përcaktosh me saktësi numrin e bizneseve sociale.

Në fund akad. Angjeli theksoi se në agjendë e suksesshme zhvillimi, kërkon partneritete gjithëpërfshirëse – në nivel global, rajonal, kombëtar dhe lokal – të ndërtuar mbi parime dhe vlera dhe mbi një vizion të përbashkët dhe qëllime të përbashkëta që vendosin njerëzit dhe planetin në qendër.

Në kuadër të pyetjeve dhe diskutimeve, akad. Aurela Anastasi falënderoi për temën e përzgjedhur dhe trajtimin interesant të një çështjeje të rëndësishme që kryqëzohet sot më drejtësinë sociale.

Akad. Anastasi foli për lidhjet me masat sociale në fushën e së drejtës. Shkencës i ka ardhur koha që të koordinoje më mirë me drejtësinë për të pasur arritje të rëndësishme.- tha akad. Anastasi.

Akad. Adrian Civici mbajti ligjëratën me temë "Zhvillimet e kulturës digjitale: cilat janë sfidat me të cilat do të përballemi"

Ai vuri në dukje se kultura e një shoqërie është domosdoshmërisht e inkorporuar në kohën e saj, organizimin e saj politik e civil, sistemet e saj të prodhimit, teknologjitë e saj.



Akad. Civici tha se për një kohë të gjatë ne e kemi konsideruar termin "kulturë" si "sinergji e besimeve, supozimeve, vlerave, normave, zakoneve, simboleve dhe gjuhës që përcakton dhe karakterizon një grup". Ky përkufizim ndryshoi me ardhjen e dixhitalit që prezantoi kulturën dixhitale dhe për rrjedhojë sinergjinë midis njerëzve dhe teknologjisë.

Duhet të bëhet dallimi midis aftësive dixhitale dhe kulturës dixhitale:

Aftësitë dixhitale janë grupe njohurish që lejojnë evolucionin afatshkurtër dhe përshtatjen me zhvillimet dixhitale – pra, një qasje taktike.

Kultura dixhitale përfaqëson aftësinë për të adoptuar një vizion afatgjatë, me shtrirje të gjerë perspektive – pra, një qasje strategjike.



Pavarësisht ndikimit të revolucionit dixhital në të gjitha fushat, brezat e rinj janë akoma të trajnuar dobët dhe kultura dixhitale në gjerësinë dhe thellësinë e saj mungon apo është akoma e pamjaftueshme në sistemet arsimore, në politikat dhe strategjitë e zhvillimit. -tha akad. Civici.

Ai theksoi se BE evidenton 5 dimensione kryesore për të matur gjendjen e kulturës dixhitale:

1.Gjendja e konektivitetit (Kapacitetet/cilesia e “lidhjes”; mbulimi 4G dhe përgatitja për 5G)

2. Kapitali njerëzor

3.Përdorimi i internetit nga qytetarët

4.Shkalla e dixhitalizimit të bizneseve

5.Shërbimet publike online.

Në fund u zhvilluan diskutime. Prof. Selami Xhepa bëri pyetje për pabarazinë që buron nga teknologjia që zëvendëson njeriun dhe nga procese të tjera që burojnë nga qëndrimet ideologjike.

Akad. Angjeli tha se liderët botërorë po ndejnë përgjegjësinë për të reduktuar elementët e pabarazisë ekonomike dhe theksoi se Akademia e Shkencave dhe Komisionit i ekonomisë, çështjeve sociale dhe juridike kanë përgjegjësinë që të analizojmë fenomenin.

www.akad.gov.al

5 shtatori, Dita e Nënë Terezës



- Ligjëratë e hapur e dr. Gëzim Alpion, anëtar i jashtëm i ASHSH: Shenjtorja Nënë Tereza, kjo ikonë bashkëkohore shpirtërore dhe njerëzore, u bë mishërimi i trashëgimisë kulturore dhe shpirtërore të kombit të saj -

- Shenjtorja Terezë transformoi konceptin e bamirësisë dhe ndihmoi formësimin e një këndvështrimi të ri të institucioneve fetare në shekullin e 20-të si organizata të punës sociale -

Në një ligjëratë të mbajtur në Akademinë e Shkencave dr. Gëzim Alpion analizoi marrëdhëniet e Nënë Terezës me vendlindjen dhe rëndësinë e kësaj ikone globale për shqiptarët.

Ai vuri theksin në veçantinë e rrethanave që përjetoi Gonxhe Anjezë Bojaxhiu dhe efektin e tyre në përcaktimin e qëndrimit të saj ndaj Shqipërisë, Kosovës dhe kombit shqiptar.



Alpion theksoi se vullneti i saj i fuqishëm njerëzor ndihmoi në ndryshimin e të kuptuarit nga bota perëndimore të varfërisë në "botën e tretë", transformoi konceptin e bamirësisë dhe ndihmoi formësimin e një këndvështrimi të ri të institucioneve fetare në shekullin e 20-të si organizata të punës sociale.

Autori eksplori jetën dhe veprën e saj nën dritën e informacionit të zbuluar rishtas për familjen e saj, traditën shpirtërore shqiptare përpara dhe pas hyrjes së krishterimit si dhe ndikimin e Vatikanit dhe fuqive të tjera mbi popullin e saj qysh nga mesjeta e hershme.

Duke u përqendruar në traumat e saj, vuajtjet dhe arritjet si individ, por edhe si misionare, si dhe në spiritualitetin e saj kompleks, Alpioni argumenton se jeta e Nënës Terezë dhe historia e kombit të saj, veçanërisht marrëdhënia e popullit të saj me katolicizmin, janë të ndërlidhura. Kjo ikonë bashkëkohore shpirtërore dhe humanitare u bë mishërimi i trashëgimisë kulturore dhe shpirtërore të kombit të saj.



Në pjesën e dytë të ligjëratës Alpion shtjelloi konceptet "hero" dhe "kapital" nga disa këndvështrime, duke u përqendruar kryesisht në veprat e Thomas Carlyle, Samuel Smiles, Daniel J. Boorstin dhe Pierre Bourdieu. Kjo është hera e parë që shtjellohet para një audience koncepti i ri "kapitalit të famës", të cilin ai po e thellon në një studim në proces, me figurën e Nënë Terezës. Alpion argumenton se teoria e kapitalit, dhe format e tij - ekonomik, social, simbolik, kulturor - ndihmojnë, por nuk mjafton për të matur "vlerën" e shtuar që Nënë Tereza solli në kulturën dhe influencën e njerëzve të famshëm. Sipas Alpion, ajo që e bën Nënë Terezën figurë emblematike të "kapitalit të famës" janë përkushtimi fetar, bamirësia pa kushte dhe bindja në shenjtërinë e dinjitetit njerëzor që, së bashku, e shndërrojnë

atë në mishëruese të vlerave më pozitive të njerëzimit.

Alpion përfundon se Nënë Tereza nuk është një rastësi. Sipas tij, personalitete të kalibrit të saj duhen studiuar në kontekstin e rrethanave personale dhe sfondin etnik, nacional, fetar, dhe kulturor me efekt brumues në jetën dhe aktivitetin e tyre. Në rastin e Nënë Terezës, këta rrethana dhe efekti i tyre akoma nuk janë zbërthyer si dhe sa duhet nga studiues të huaj dhe shqiptar. Kjo është si pasojë e mos distancimit, aq i

domosdoshëm në angazhimin me figura të tilla komplekse, dhe tutjen e pajustificueshme për të dekonstruktuar dhe çmitizuar personalitetin e saj kompleks.

<https://youtu.be/N1wsAmboUMA?si=nZGLLrhGw0XzAVmS>

Akad. Arben Merkoçi, drejtues i njësisë "NanoAlb" pranë Akademisë së Shkencave - referues në seancën plenare të kongresit të 6-të ndërkombëtar për biosensorët organizuar në Konya (Turqi), nga Universiteti i "Necmetin Erbakan"



Akad. Merkoçi referoi online në këtë kongres. Në faqen e tij ai shkruan:

"I couldn't be today in Turkey in person so just gave the plenary talk online. I thank very much the invitation from the organizers of the 6th International Congress on Biosensors organized at Necmettin Erbakan University, Konya. I missed meeting so many friends in Konya, the nice city in the Central Anatolia Region of Turkey.

I love going in Turkey and today was like being there. Many colleagues and friends from Turkey have been part of our group and have contributed significantly to

our research. Wish more excellent students from Turkey will come in Barcelona and work together in developing new generation of nanobiosensors for diagnostics and more.

Akad. Nazim Gruda hapi sot seminarin shkencor “Burimet e reja natyrore të molekulave bioaktive për ushqimin e njerëzve dhe të kafshëve” në Universitetin Lituanëz të Shkencave Shëndetësore në Kaunas



Në seminarin “New natural sources of bioactive molecules for human and animal nutrition” (Burimet e reja natyrore të molekulave bioaktive për ushqimin e njerëzve dhe të kafshëve), që u mbajt në Universitetin Lituanëz të Shkencave Shëndetësore në Kaunas, akad. Nazim Gruda ndau me të pranishmit njohuritë mbi strategjitë për të përmirësuar cilësinë e frutave dhe perimeve në kontekstin e të ushqyerit të shëndetshëm, në kuadër të projektit të Zyrës Ndërlidhëse të Universitetit Baltiko-Gjerman dhe Shërbimit Gjerman të Shkëmbimit Akademik (DAAD), që mundësuan financimin e këtij projekti përmes Ministrisë së Jashtme të Republikës Federale të Gjermanisë.

Ky projekt baltiko-gjerman u bë i mundur falë kontakteve shkencore dhe profesionale të krijuara gjatë vizitës së delegacionit të Akademisë së Shkencave të

Shqipërisë në Lituani në shtatorin e vitit të shkuar. Dy akademitë kanë nënshkruar një kontratë bashkëpunimi, dhe në tetor të këtij viti, pritet që Kryetari i Akademisë së Shkencave të Lituanisë të vizitojë Shqipërinë.



Akad. Gruda do të marrë pjesë gjithashtu dhe në konferencën e 4-të ndërkombëtare mbi aktualitetet shkencore dhe inovacionet në hortikulturë që do të mbahet gjatë këtij viti po në Kaunas, Lituani!

Tema e kësaj konference është “Rrjetet e vlerave të hortikulturës”, organizuar nga Qendra Kërkimore Lituanëze për Bujqësinë dhe Pylltarinë dhe Shoqata Nordike e Shkencave Bujqësore.

www.akad.gov.al

Sesioni shkencor me temë “Antifashizmi shqiptar, si vlerë mbarëshqiptare”



Sot më 16 shtator 2024, në kuadrin e 80-vjetorit të çlirimit të vendit dhe 82-vjetorit të Konferencës së Pezës, Kuvendi i Shqipërisë, në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe Akademinë e Studimeve Shqiptare, organizoi në sallën e seancave plenare sesionin shkencor me temë “Antifashizmi shqiptar, si vlerë mbarëshqiptare”.



Kryetarja e Kuvendit, znj. Elisa Spiropali, mbajti një përshëndetje të veçantë në këtë veprimtari, ku gjithashtu referuan studiuesit prof. Paskal Milo, prof. Nevila Nika, prof. Hamit Kaba, prof. asoc.. Marenglen Kasmi dhe Florian Çullhaj.

Ky sesion, i organizuar, në ditën e përvjetorit të Konferencës së Pezës, kishte si qëllim theksimin e karakterit gjithëpërfshirës të rezistencës antifashiste shqiptare, ku populli shqiptar, “pa dallim krahine, feje e ideje”, u bashkuan për të luftuar pushtuesit fashistë.

Për më tepër shih linkun:

<https://www.facebook.com/share/p/TA5RykDXAnfTrs4P/?mibextid=oFDknk>

Akad. Nazim Gruda merr pjesë në konferencën e 4-t ndërkombëtare mbi aktualitetet shkencore dhe inovacionet në hortikulturë (Kaunas, Lituani)



- Kryetari i Akademisë së Shkencave të Lituaniës Jūras Banys (anëtar i bordit drejtues të ALLEA-s - "All European Academies") do të vizitojë Akademinë e Shkencave të Shqipërisë në 15-18 tetor 2024 -

Tema e këtij viti ishte "Rrjetet e vlerave të hortikulturës". Veprimtaria u organizua nga qendra kërkimore lituaneze për bujqësinë dhe pylltarinë; shoqata nordike e shkencave bujqësore dhe Akademia e Shkencave e Lituaniës.

Më shumë se 50 pjesëmarrës u përshëndetën në emër të mikpritësve nga akad. Giedre Samouleine.



Akad. Nazim Gruda mbajti si folës kryesor ligjëratën me titull "Cilësia e produktit, vlerat dhe kriteret për perimet në zinxhirin e furnizimit".


Gruda është gjithashtu anëtar i komitetit shkencor dhe drejton sesionin "Kultivimi i qëndrueshëm dhe biodiversiteti".



Akademia e Shkencave e Shqipërisë ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Akademinë e Shkencave të Lituanisë. Në tetor të këtij viti kryetari i Akademisë së Shkencave të Lituanisë akad. Jūras Banys do të vizitojë Shqipërinë.

www.akad.gov.al

Akad. Nazim Gruda, folës kryesor dhe bashkëdrejtues i simpoziut për kultivimin në mjedise të mbrojtura, rrjetat dhe mbulesat e tjera, që po mbahet në Athinë



Këto ditë po mbahet në Athinë simpoziumi ndërkombëtar për kultivimin në mjedise të mbrojtura, rrjetat dhe mbulesat e tjera për vendet me klimë të moderuar.

Në simpoziumin për mjediset e mbrojtura marrin pjesë personalitete të njohura të shkencës, mes tyre dhe akad. Nazim Gruda, anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Akad. Gruda është i njohur për kontributin e tij në hortikulturën e qëndrueshme dhe përmirësimin e cilësisë së perimeve.

Më 23 shtator 2024, ai çeli ditën e parë të simpoziut si folësi kryesor.

Ai prezantoi kërkimin shkencor "Nga serra në tryezë: Ndikimi i kushteve para vjeljes në cilësinë e perimeve në mjedise të mbrojtura". Prezantimi i akad. Grudës ofron strategjitë më të fundit dhe zgjidhjet praktike për të përmirësuar cilësinë e perimeve në mjedise të mbrojtura.

Simpoziumi do të vijojë punimet me diskutime shkencore deri më 26 shtator 2024.

Kjo veprimtari organizohet nga Universiteti Bujqësor i Athinës në Greqi dhe Shoqata Ndërkombëtare e Hortikulturës me qendër në Bruksel, Belgjikë.

Çelet ekspozita “Trigonometria shpirtërore e Danjollit” në Akademinë e Shkencave



Qendra e Studimit të Arteve pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë çeli sot në ambientet e jashtme ekspozitën “Trigonometria shpirtërore e Danjollit” me autor dr. Hajdar Danjollin, kuruar nga Artan Shabani.

Ekspozitën e çeli drejtori i Qendrës së Artit Stefan Çapaliku, i cili i vlerësoi veprat e dr. Danjollit për ndjeshmërinë e hollë dhe tërësinë e motiveve e teknikave që ka përdorur. Ai theksoi se Danjollit është një artist që iu përket dy periudhave asaj të artit të angazhuar dhe periudhës pas viteve '90, ku artisti mban një qëndrim më bashkëkohor dhe e kompozon trajtimin e tekstit brenda tablosë.

I pranishëm në ekspozitë ishte zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Vasil Tole. Ai përshëndeti të pranishmit dhe përgëzoi autorin Danjollit për punimet e kujdesshme, interesante dhe shumë të veçanta në raportet me motive kombëtare.

Kuratori Artan Shabani theksoi se piktura e dr. Danjollit ka një forcë kulmore ekzekutive dhe një tension të fortë imagjinate, e cila është në të njëjtën kohë epike për magnetizimin e tij.



Ekspozita vetjake e dr. Hajdar Danjollit vjen për herë të parë në Akademinë e Shkencave. Kjo ekspozitë shfaq rreth 20 punime, të cilat u referohen tekstileve dhe në mënyrë metaforike tiparit piktorik të artistit.

www.akad.gov.al



Takime pune

Takim pune me një përfaqësi të Akademisë së Shkencave të Rumanisë



Sot më 2 shtator 2024 zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Vasil Tole zhvilloi një takim pune me një përfaqësi të Akademisë së Shkencave të Rumanisë drejtuar nga prof. Emil Tircomnicu, studiuesen e gjeografisë humane Catalin Alexa dhe studiuesen Elsa Stavro.

Në këtë takim ishin të pranishëm drejtori i Institutit të Antropologjisë, prof.assoc.dr. Olsi Lelaj, dhe dr. Ledi Shamku Shkreli.

Qëllimi i takimit ishte diskutimi mbi bashkëpunimin dhe arritjen e marrëveshjeve bilaterale të Institutit të Antropologjisë, pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, me Institutin e Etnografisë dhe Folklorit, Akademia e Shkencave e Rumanisë.

Në këtë takim u fol për pikat konkrete të marrëveshjes si dhe projektet e përbashkëta që do të zhvillohen në kuadër të saj.

www.akad.gov.al

**Akad. Skënder Gjinushi, Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë,
priti sot në një vizitë zyrtare ambasadoren e Zvicrës znj. Ruth Huber**



Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushi priti sot në një vizitë zyrtare ambasadoren e Zvicrës znj. Ruth Huber.

Të pranishëm ishin kryetari i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike akad. Gëzim Hoxha, shefja e marrëdhënieve me jashtë prof. asoc. dr. Elda Zotaj.

Takimi u organizua me rastin e përgatitjeve të simpoziumit të përbashkët shkencor për figurën e dijetarit albanolog (arkeolog, antropolog, kryesues shërbimesh humanitare Eugéne Pittard, që do të mbahet më 9 tetor 2024.



Takimi u përqendrua në fillim rreth figurës shumëdimensionale të Eugène Pittard në rrethet akademike të Shqipërisë. U fol për rolin e tij në njohjen e Shqipërisë si shtet dhe anëtarësimin në Lidhjen e Kombeve (1920), si dhe për kontributin e tij si arkeolog, antropolog dhe si bashkëthemelues i Kryqit të Kuq Shqiptar me gruan e tij Heléné Pittard.

Gjatë këtij takimi u theksua se Eugène Pittard është zbuluesi i parë i sitit të lashtë arkeologjik të Trenës në Korçë (1924). Puna e tij ka nxitur studiues dhe arkeologë të tjerë zviceranë, ku u përmend kontributi i arkeologut të njohur Albert Hafner, që udhëheq ekipin shqiptaro-zviceran të kërkimeve arkeologjike në këtë zonë dhe që do të jetë i pranishëm dhe në ditën e konferencës më 9 tetor 2024.



Bashkorganizimi i një veprimtarie shkencore jubilarë në nderim të figurës dhe kontributit të studiuesit Eugène Pittard prej Ambasadës së Zvicrës dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë do të shërbejë dhe si një nxitje për të tjera nisma dhe organizime të përbashkëta. Mes këtyre nismave, me rëndësi është edhe përfshirja e studiuesve e albanologëve të të dy vendeve në projektin madhor të “Enciklopedisë shqiptare”.

Në shtyp:

<https://www.google.com/.../gjinushi-pret-ambasadoren-e.../>

<https://www.oranews.tv/.../gjinushi-pret-ambasadoren-e...>

https://www.google.com/search?q=gjinushi&sca_esv=566487c1e8374dca&sca_upv=1&prmd=ivn&sxsrf=ADLYWIKY24dz3G0tLiuEWTFk_YLS3vLdLQ:1726848597911&source=Int&tbs=qdr:d&sa=X&ved=2ahUKewj1qomq9NGIAxVdi_0HHdijMvMQpwV6BAgGEAo&biw=393&bih=736&dpr=2.75

<https://www.gazetatema.net/.../simpozium-i-perbashket...>

www.akad.gov.al

Vlerësime

Ceremoni e dorëzimit të diplomave dy anëtarëve të jashtëm të Akademisë - dr. Gëzim Alpion e dr. Lulzim Tafa

Me këtë rast z. Gëzim Alpion paraqiti ligjëratën e hapur “Shenjtoria Nënë Tereza - ikonë globale e kombit shqiptar”



Në ceremoninë e organizuar nga Akademia e Shkencave për dorëzimin e diplomave të pranimit si anëtarë të jashtëm të saj dr. Gëzim Alpion dhe dr. Lulzim Tafa ishin të pranishëm Kryetari akad. Skënder Gjinushi, anëtarë të Kryesisë, akademikë e studiues, diplomatë, ministra e deputetë të mëparshëm.

I pranishëm imzot Frenzo, arkipeshkv i Tiranës e Durrësit; përfaqësues të qeverisjes vendore të Dibrës, studiues e miq nga Kosova e MV.

Veprimtarinë e hapi akad. Shaban Sinani, sekretar shkencor i Akademisë së Shkencave. Ai tha se në mbledhjen e datës 22 prill 2024, me vendimin nr. 43, Asambleja e ASHSH pranoi në radhët e anëtarëve të jashtëm të saj disa personalitete të dijes dhe letrave shqipe, dy prej të cilëve kemi nderin dhe kënaqësinë të jenë të pranishëm në këtë sallë.

Në fjalën e tij akad. Sinani theksoi se Gëzim Alpion është autor i shtatë veprave monografike; i njohur si biografi më i besueshëm për Nënë Terezën, vepër e përkthyer dhe botuar mbi 15 herë; autor i 17 artikujve shkencorë dhe kritikë e i disa librave

artistikë. Vepra të tij janë të recensionuara në më shumë se 100 raste. Alpion është profesor në Universitetin e Birmingham-it.



Dr. Lulzim Tafa njihet për veprimtarinë e tij botuese të pandërprerë prej më shumë se tri dekadash, me një profil intelektual të spikatur në fushën e kërkimit shkencor; doktor i shkencave në drejtësi, i njohur dhe për veprimtarinë universitare dhe pjesëmarrjen qytetare. Lulzim Tafa është anëtar i Akademisë Europiane të Shkencave dhe i Akademisë së Shkencave të Bosnjës.

Duke i uruar dy anëtarët e rinj për suksesin e tyre, akad. Sinani shprehu kënaqësinë për zgjerimin e radhëve të Akademisë me personalitete të këtij niveli dhe ftoi Kryetarin e ASHSH akad. Skënder Gjinushin për dorëzimin e diplomave. Tafa ka fituar çmime europiane në krijimtari ("Neruda", "Eminescu") dhe mirënjohjen e Presidentit të Francës "Ordre des artes e de literature".

Akad. Gjinushi përshëndeti të pranishmit dhe ftoi profesorët Gëzim Alpion dhe Lulzim Tafa për t'u dorëzuar diplomat si anëtarë të jashtëm.

Anëtarët e rinj falënderuan Asamblenë e Akademisë së Shkencave për pranimin me votim si anëtarë të jashtëm dhe shprehën vlerësime për veprimtarinë e kësaj akademie.



Më pas, prof. Gëzim Alpioti paraqiti leksionin e hapur me temë “Shenjtorja Nënë Tereza - ikonë globale e kombit shqiptar”.

Në këtë ligjëratë dr. Alpioti e vlerësoi Nënë Terezën si figurë emblematike që u shndërrua në mishëruese të vlerave më pozitive të Njerëzimit. Ai theksoi se Nënë Tereza nuk është një rastësi. Sipas tij, personalitete të lartësisë së saj duhen studiuar në kontekstin e rrethanave personale dhe me sfondin etnik, nacional, fetar dhe kulturor me efekt brumues në jetën dhe aktivitetin e tyre.



Në fund, u bënë pyetje dhe diskutime rreth figurës së shenjtores Terezë me origjinë shqiptare.

www.akad.gov.al

Në shtyp:

<https://www.kosovarja-ks.com/cfare-tha-poeti-lulzim-tafa.../>

<https://rrugaearberit.com/.../akademia-e-shkencave.../>

<https://klankosova.tv/fjala-e-poetit-lulzim-tafa-me.../>

<https://www.kosovarja-ks.com/lulzim-tafa-anetar-i.../>

<https://atvlive.tv/lulzim-tafa-ben-pranimin-zyrtar-si.../>

<https://youtu.be/cSv8MWYRLTc?si=6F8ZarhSR1-fz7O4>

<https://www.epokaere.com/lulzim-tafa-edhe-zyrtarisht.../>

<https://alb-spirit.com/.../lulzim-tafa-ben-pranimin.../>

<https://youtu.be/cSv8MWYRLTc?si=sgOMEY9IDNUzSFcj>

https://youtu.be/WiNPDW_nHaI?si=FQ7z1VC574aCjT9v

[https://www.balkanweb.com/perkujtohet-nene-tereza-mes.../...](https://www.balkanweb.com/perkujtohet-nene-tereza-mes.../)

<https://startnews.news/.../dr-gezim-alpion-pranohet-nga.../>

<https://www.voal.ch/me-4-shtator.../multimedia/press/>

Anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, njëherazi presidenti i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, akademik Anastas Angjeli, vlerësohet me çmimin ndërkombëtar Books for Peace 2024” për kontributin e tij në dobi të paqes



Çmimi iu dorëzua gjatë një ceremonie të veçantë që u zhvillua në godinën e Parlamentit Europian të Italisë, Piazza Venezia të Romës, në sallën David Sassuoli.

Prof. Antonio Imeneo, presidenti i organizatës ndërkombëtare Books for Peace, i dorëzoi çmimin akad. Anastas Angjelit në praninë e një audience të zgjedhur vendase e ndërkombëtare, politike, diplomatike dhe me përfaqësues të medias.

Ceremonia për dhënien e këtij çmimi përmbylli konferencën e organizuar nga organizata ndërkombëtare Books for Peace, UNIFUNVIC UNESCO CLUBS BRAZIL BUCA / EUROPE, në bashkëpunim me Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë, Ambasadën e Shqipërisë në Vatikan, Forumin Diplomatik Shqiptar dhe Gazetën Diplomatike italiane.

Konferenca me temën “Qytetarët e botës, kultura për një paqe të shëndoshë dhe të qëndrueshme”, u hap nga akad. Anastas Angjeli. Ai prezantoi kumtesën “Paqja dhe zhvillimi i qëndrueshëm: Prosperitet global për qytetarin global”.

Përmes këtij prezantimi shkencor akad. Angjeli evidentoi lidhjen e thellë midis zhvillimit të qëndrueshëm dhe paqes e karakterin shumëplanësh të saj, duke nënvizuar rëndësinë e ndërlidhjes dhe bashkëpunimit, si dhe qasjet e integruara të zhvillimit të qëndrueshëm.

<https://360grade.al/.../akademik-prof-dr-anastas-angjeli.../>

www.akad.gov.al

www.akad.gov.al

Të tjera

Diskutohet projekti i rregullores së re për periodikët që botohen nga Akademia e Shkencave dhe rrjeti i instituteve të saj



Mbledhja u drejtua nga akad. Skënder Gjinushi, kryetar i Akademisë së Shkencave -

- Me pjesëmarrjen e kryeredaktorëve, të koordinatorëve shkencorë të revistave periodike dhe të anëtarëve të grupit hartues -

- Projekti është hartuar nga grupi i punës që u ngrit nga Kryesia në fillim të vitit, me ribashkimin e instituteve të albanologjisë me Akademinë -



- Qëllimi: një politikë editoriale harmonike, që mundëson plotësimin e standardeve kombëtare e ndërkombëtare të indeksimit të periodikëve shkencorë, duke përfshirë aktet nënligjore për klasifikimin e revistave shkencore në Shqipëri dhe për vlerësimin e punës kërkimore.

- Projekti do të diskutohet edhe me bordin e drejtorëve të njësive shkencore dhe më tej do të shërbejë si rregullator bazë i botimeve periodike të Akademisë së Shkencave dhe rrjetit të instituteve pranë saj.

**Akademia e Shkencave është një tempull që i shërben kombit dhe Shqipërisë
- kjo është arsyeja kryesore pse e pranova me shumë kënaqësi anëtarësimin si
i jashtëm**

- Gëzim Alpion, anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave, i ftuar në "Pas mesnate" (ABC) për figurën e Nënë Terezës



- Po njihem më në thellësi me Akademinë dhe me kolegët akademikë: kemi studiues akademikë të nivelit ndërkombëtar

- Akademia jonë e Shkencave ka mbajtur qendrimë dinjitoze; nuk e ka bërë gabimin e disa akademive në rajon, që i kanë shërbyer një nacionalizmi shovinist

- Në trajtimin e problemeve të identitetit kombëtar, të lashtësisë etj. Akademia ka rol kryesor: ky është dhe përkushtim imi

- Diaspora historike është krijuese e shtetit shqiptar - sot kemi një diasporë shkencore shqiptare edhe më elitare se më parë; kjo elitë nuk duhet të sillet me arrogancë: ne që jemi në diasporë e që vijmë nga jashtë mund të japin ndihmën tonë modeste, por pa iu imponuar askujt: duhet të ketë dialog midis saj dhe shtetit shqiptar

- Anëtarët e Akademisë nuk janë "intelektualë publikë" (sipas shprehjes së njohur të Sartrit); akademikët problemet i shtrojnë, i diskutojnë dhe i zgjidhin brenda saj, në Asamble

- Tre projektet madhore në albanologji, duke qenë edhe bashkëpunime me ASHAK-un, janë për t'u nixitur e mbështetur deri në përfundimin me sukses; duhet të kemi kooperim të eksperiencave në Shqipëri e në Kosovë



MOTHER TERESA

Saint or Celebrity?

Gëzim Alpion

Të plotë në linkun:

<https://www.youtube.com/watch?v=X7bO5UzicBU...>

Tre anëtarë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë përsëri në listën e shkencëtarëve më të shquar në Botë

Tre anëtarë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë përsëri në listën e shkencëtarëve më të shquar në Botë mbështetur në "Bazën e përditësuar të të dhënave të autorëve në mbarë Botën sipas treguesve të standardizuar të citimeve" ("Updated science-wide author databases of standardized citation indicators / top list of 2 % of scientists of the World")

- Përgëzime kolegëve akademikë Arben Merkoçi, Nazim Gruda dhe Sokrat Sinaj-


A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N
Sotelo, Miguel Ángel	Universidad de Alcalá	esp	241	1994	2024	112,261	5,269	35	17,1377	19	197	41	538
Xia, Qing	Beijing Electric Power Tradchn		342	1994	2020	112,263	12,672	61	25,1096	1	13	17	247
Lederman, Robert J.	National Heart, Lung, and	usa	250	1996	2024	112,265	6,464	38	13,8572	4	71	22	1,211
Gunter, Helen M.	The University of Manchesgbr		178	1995	2024	112,266	2,034	24	19,9167	49	483	109	1,153
Rotman, Marvin	SUNY Downstate Health Scusa		186	1961	2019	112,267	26,772	51	13,5224	3	13	39	1,162
Apetoh, Lionel	Inserms	fra	130	2006	2024	112,268	24,204	60	14,5676	2	1	14	3,817
Gilkes, Robert J.	The University of Western aus		308	1970	2024	112,269	6,958	45	27,5040	6	33	25	294
Yeager, Stephen G.	National Center for Atmos usa		113	2004	2024	112,270	6,801	41	13,4861	2	70	16	1,037
Bagchi, Prosenjit	Rutgers University–New Brusa		66	2000	2024	112,271	2,616	28	17,9762	4	251	21	1,191
Li, Xuesong	University of Electronic Sci chn		84	2001	2024	112,272	36,039	38	8,2814	0	0	15	16,362
Kawachi, Masao	Nippon Telegraph and Telijpn		143	1971	2006	112,274	3,057	28	13,6345	11	605	39	918
Gruda, Nazim S.	Universität Bonn	deu	128	1997	2024	112,275	2,822	24	14,9417	8	638	34	1,101
Pless, Robert	The George Washington Uusa		147	1997	2023	112,277	5,522	32	14,7818	8	333	15	548
Greenblatt, David	Technion - Israel Institute isr		160	1989	2024	112,278	3,520	29	14,5429	17	139	71	2,369
McNeill, Katherine L.	Boston College	usa	57	2004	2024	112,279	3,205	26	14,3360	2	262	19	1,864
Gryczynski, Ignacy	Texas Christian University usa		528	1975	2024	112,282	11,559	49	25,3790	1	5	77	1,331
Stahl, Dale O.	The University of Texas at usa		69	1977	2020	112,283	2,215	20	16,3867	33	658	46	1,740
Cademartiri, Filippo	Consiglio Nazionale delle Fita		597	1999	2024	112,284	15,719	62	16,1101	5	4	118	2,355
Robinson, Edwin H.	Mississippi State Universit usa		146	1978	2023	112,285	3,761	35	20,4206	3	97	42	1,075
Halfens, Ruud J.G.	Universiteit Maastricht	nld	320	1985	2022	112,287	9,387	53	24,9260	3	25	22	349
Ni, Zhenhua	Southeast University	chn	245	2005	2024	112,288	21,607	64	15,7421	0	0	15	4,263
Little, Susan E.	Oklahoma State University usa		162	1996	2024	112,289	3,911	36	16,3797	12	170	37	935
Debinski, Waldemar	Wake Forest University Scusa		171	1985	2023	112,290	4,854	37	17,9134	11	72	48	1,275

Për më shumë informacion:

<https://elsevier.digitalcommonsdata.com/data.../btchxktzyw/7>

Ioannidis, John P. A. (2024), "August 2024 data-update for "Updated science-wide author databases of standardized citation indicators"", Elsevier Data Repository, V7, doi: 10.17632/btchxktzyw.7

**Qendra Kërkimore e Bioteknologjisë dhe Gjenetikës e Akademisë së
Shkencave boton artikullin e 5-të mbi ecurinë e përgjigjes imunitare të
popullatës shqiptare ndaj COVID 19**



Revista shkencore “International Journal of Infection –diseases Control” ka botuar artikullin e grupit të punës së drejtuar nga akad. Genc Sulçebe me titullin “Dinamika e antitropave anti-SARS-CoV-2 në popullatën shqiptare: Ndikimi i imunitetit të shkaktuar nga infeksioni dhe vaksina gjatë pandemisë COVID-19” (Dynamics of anti-SARS-CoV-2 antibodies in the Albanian population: Impact of

infection- and vaccine-induced immunity during the COVID-19 pandemic).

Ky është artikulli i pestë i botuar nga Qendra Kërkimore e Bioteknologjisë dhe Gjenetikës (QKBGj) në shtypin shkencor ndërkombëtar mbi ecurinë e përgjigjes imunitare të popullatës shqiptare ndaj COVID 19.

Studimi ka në fokus shprehjen e dinamikave të reagimit imunitar gjatë pandemisë COVID-19 dhe ofron njohuri mbi dinamikën e reagimit imunitar humoral, i cili është thelbësor për përsosjen e strategjive të vaksinimit kundër COVID-19 në vendet me të ardhura mesatare me mbulim të ulët vaksinimi dhe shkallë të lartë infeksioni.

Akad. Genc Sulçebe, për vlerësimin e studimit nga revista shkencore ndërkombëtare, i ka shprehur mirënjohjen e tij Kryesisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe veçanërisht prof. Skënder Gjinushit.

Ai tha se ky studim është unik në rajon për realizimin e tij në një popullatë të vetme si dhe gjatë gjithë dinamikës trevjeçare të pandemisë.

Për artikullin e publikuar shih linkun:

<https://www.sciencedirect.com/.../pii/S2772707624001115>

InterAcademy partnership (IAP) në buletin elektronik për muajin shtator publikon artikullin për Akademinë e Shkencave dhe qendrën kërkimore NanoAlb

Buletini elektronik i muajit shtator të IAP në seksionin e lajmeve për akademitë anëtare ka publikuar artikullin ku thekson ndikimin e NanoAlb si një qendër kërkimore bashkëpunuese e nanoteknologjisë e krijuar nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë në vitin 2019.

Në artikull nënvizohet se NanoAlb adreson sfida kombëtare në sektorë të tillë si shëndetësia, bujqësia, etj, dhe se kjo qendër ka krijuar rrjete bashkëpunimi midis universiteteve, qendrave kërkimore dhe diasporës shkencore shqiptare.

Artikulli ndan për lexuesit europianë dhe publikimin e raportit të zhvillimit të Bankës Botërore 2024.

Për më tepër shih linkun:

<https://sh1.sendinblue.com/ajcx8nllz9pfe.html...>

www.akad.gov.al

Sot është dita kombëtare e trashëgimisë kulturore



- Akademia e Shkencave përkujton me nderim dhe mirënjohje ata që i krijuan, i ruajtën vlerat e trashëgimisë kulturore dhe ua përcollën brezave si dëshmi të identitetit kulturor kombëtar e europian

- Akademia e Shkencave është institucion kontribues për legjislacionin në fuqi për trashëgiminë materiale e jomateriale kombëtare

- Përfaqësues të AShSh - bashkëhartues të disa dosjeve shkencore aktuale për promovim në Unesco, midis tyre: lahuta dhe këngët me lahutë, xhubleta, Moti i Madh arbëresh



29 shtatori është dita kur kujtojmë me respekt trashëgiminë kombëtare shqiptare,

si pjesë të pandarë të trashëgimisë kulturore europiane. Kjo është dita ku të gjitha vlerat e trashëgimisë materiale e shpirtërore bëhen një për mesazhet që përcjellin.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë ka një ndër objektivat e saj kërkimin shkencor në fushën e trashëgimisë dhe mbrojtjen e vlerave të saj.

Me këtë rast ASHSH shpreh mirënjohje për kontributin e restauratorëve, arkeologëve, arkitektëve, studiuesve dhe shkencëtarëve, bartësve të folklorit dhe artizanëve, të njohur apo anonimë, që i kanë dhënë kuptim identitetit tonë kombëtar.

www.akad.gov.al

Një veprimtari e ASHSH në nderim të kësaj dite:

<https://youtu.be/YNQhhok9q1Q?si=kcmNH7BX-W1Zn5bc&sfnsn=wa>

Botime të reja

Botohen "në linjë" aktet e konferencës shkencore ndërkombëtare kushtuar Shtetit të Arbërit dhe shekujve të humanizmit europian në botën shqiptare

Akademia e Shkencave e Shqipërisë

**Nga "Shteti i Arbërit" tek Arbëria
në shekujt e humanizmit europian**

Akte të konferencës shkencore ndërkombëtare

Tiranë, 9-10 tetor 2023

Tiranë, 2024

Botohen "në linjë" aktet e konferencës shkencore ndërkombëtare kushtuar Shtetit të Arbërit dhe shekujve të humanizmit europian në botën shqiptare, organizuar vitin e shkuar nga Akademia e Shkencave, me bashkëpunimin e albanologëve të huaj dhe vendës

Përveç fjalës përshëndetëse nga kryetari i Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi, vëllimi përman 24 kumtesa të referuesve të kësaj konference, zhvilluar në Gëziq e në Tiranë: arkeologë, historianë të Mesjetës, antropologë,

studiues të shkencave të trashëgimisë dhe identiteti, ndër të cilët albanologët e njohur Lucia Nadin, Andrea di Giuseppe, Pëllumb Xhufi etj.

Komiteti shkencor-organizues (Shaban Sinani, Pëllumb Xhufi, Gëzim Hoxha) në vëllim ka përgjegjësinë e redaksisë shkencore.

Redaktimi i librit nga dr. Brunilda Prifti.

Së shpejti vëllimi do të botohet edhe i shtypur.

In memoriam

**Sot ditëlindja e themeluesit të shkollës moderne të historiografisë shqiptare,
bashkëthemeluesit dhe kryetarit historik të Akademisë së Shkencave, Aleks
Buda**



Kryesia e Akademisë së Shkencave nderon sot, në ditën e lindjes, figurën shumëplanëshe të Aleks Budës, me emrin dhe veprën e të cilit lidhet lindja dhe shndërrimi në shkollë i albanologjisë vendëse; formulimi e argumentimi i tezave themelore të saj; ngritja e institucioneve të specializuara për kërkime të thelluara në historiografi, etnogjenezë, arkeologji dhe disiplina të tjera; prijës i studimeve shqiptare për Mesjetën, lashtësinë dhe momentet kyçe të historisë kombëtare, duke përfshirë

Lidhjen Shqiptare të Prizrenit dhe luftën antifashiste; "i martuar me historinë e i dashuruar me arkeologjinë"; personifikim i arritjeve më cilësore të dijes shqiptare në gjysmën e dytë të shekullit të 20-të e në vijim; mentor i disa brezave të historianëve në Shqipëri e Kosovë; figurë referenciale për albanologjinë në Botë; bashkëthemelues dhe kryetar historik i Akademisë së Shkencave prej fillimit deri sa ishte në jetë.

Në shtyp:

<https://gazetadielli.com/aleks-buda-in-memoram/>

<https://www.facebook.com/share/p/rgMcsUs4yRfMPH38/?mibextid=oFDknk>